



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS



MEMORANDUM MIRËKÛPTIMI

NË MES

KDI

DHE

KUVENDIT TË KOSOVËS

Lidhur me fuqizimin e mbikqyrjes së Kuvendit ndaj Qeverisë dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi

MEQENËSE qëllimi i KDI-së është të bashkëpunojë me Kuvendin e Kosovës për të fuqizuar mbikqyrjen parlamentare të ekzekutivit, ngritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe rritjen e komunikimit publik rreth çështjeve që kanë të bëjnë me dialogun Kosovë-Serbi për ta bërë dialogun më transparent dhe gjithëpërfshirës.

MEQENËSE qëllimi i KDI-së është të ofrojë mbështetje për grupet parlamentare, komisionet parlamentare dhe deputetët të ushtrojnë rolin e tyre mbikqyrës në mënyrë më efektive për procesin e dialogut Kosovë-Serbi.

MEQENËSE qëllimi i KDI-së është përmirësimi i komunikimit bilateral në mes Kuvendit dhe Qeverisë në lidhje me procesin e dialogut për të garantuar një proces më gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës, për të garantuar gjithashtu një qeverisje më transparente dhe demokratike.

MEQENËSE Kuvendi si institucion, udhëheqësit e partive politike, grupet parlamentare dhe të zgjedhurit e qytetarëve përkatësisht deputetët duhet të jenë më proaktiv në mbikqyrjen e procesit të dialogut duket përdorur mekanizmat mbikqyrës si pyetjet parlamentare dhe interpelancat si dhe komunikimin/diskutimin me qytetarët.

MEQENËSE Kuvendi si institucion dhe të zgjedhurit e qytetarëve përkatësisht deputetët synojnë të mbajnë të informuar qytetarët për çështjet që ndërliken me dialogun si dhe rrisin pjesëmarrjen qytetare në këtë proces.

MEQENËSE Kuvendi i Kosovës e ka për mandat të mbikqyr punën e Qeverisë në procesin e dialogut në bazë të rezolutave të adoptuara në Kuvend përkatësisht me pikën 6 të Rezolutës 04-R-001 (Mars 10, 2011) dhe të sigurojë përfshirjen e komisioneve e nevojshme të Kuvendit.

Prandaj tani, palët kanë arritur mirëkuptimin vijues:

1. QËLLIMI

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MM) është të përcaktoj parimet udhërrëfyese të bashkëpunimit ndërmjet KDI-së dhe Kuvendit të Kosovës, si dhe të përshkruajë pritjet e të dy Palëve. Prandaj Palët kanë lidhur këtë Memorandum Mirëkuptimi (MM) për të përcaktuar veprimet e tyre të propozura lidhur me mbështetjen e tyre të këtij qëllimi.

2. VEPRIMET E KDI-SË

KDI synon të sigurojë mbështetjen e mëposhtme për Kuvendit e Kosovës:

- Ofrimin e asistencës dhe ekspertizës për grupet parlamentare, komisionet parlamentare dhe deputetët me anë të ekspertizës lokale, ndërkombëtare si dhe ngritje kapacitetesh për të adresuar në mënyrë efektive mbikqyrjen e procesit të dialogut përfshirë mbështetje teknike për draftimin e pyetjeve parlamentare përfshirë marrjen e praktikave/trajnimeve nga parlamenti zviceran.
- Lehtësimin e organizimit të takimeve/tryezave të diskutimit në mes të legjislativit dhe ekzekutivit për raportime të rregullta për çështje që kanë të bëjnë me dialogun, për të diskutuar rreth rëndësisë dhe modalitetet e përfshirjes së legjislativit në procesit e dialogut¹.
- Mbështetje me hulumtime parlamentare për komisionet parlamentare, deputetët, grupet parlamentare, në lidhje me temat e dialogut përmes Drejtorisë për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv (DHBA), gjatë 20 muajve të ardhshëm. Temat do të derivojnë nga kryetarët e komisioneve, bazuar në nevojat specifike të tyre, dinamikën e dialogut dhe agjendën legjislative 2016-2018.
- Ofrimin e mbështetjes për organizimin e dëgjimeve publike në rajonet e Kosovës, takime në mes qytetarëve dhe përfaqësuesëve të Kuvendit si dhe vizita në terren të deputetëve për të diskutuar temat, sfidat si dhe marrëveshjet që derivojnë nga procesi i dialogut. Si dhe organizimin e tryezave në nivel kombëtar në koordinim me Kuvendin dhe Qeverinë për të diskutuar për argumentet pro dhe kundër çështjeve më të ndjeshme/rëndësishme të dialogut, gjatë 20 muajve të ardhshëm.
- Lehtësimin e diskutimeve ndërmjet komisioneve dhe grupeve parlamentare rreth mënyrave më efektive për të monitoruar procesin e dialogut, përfshirë mundësinë e krijimit të një komisioni të veçantë për procesin e dialogut.
- Ofrimin e platformës online 'Vota Ime' për të monitoruar performancën e legjislativit rreth temave që ndërlidhen me dialogun, duke ofruar informacione rreth rezolutave, ligjeve,

¹ Në bazë të rezolutës së aprovuar në Kuvend Nr. 04-R-08 lidhur me normalizimin e marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë (tetor 2012) ndër të tjera autorizohet qeveria për të udhëhequr procesin dhe për të siguruar përfshirjen e komisioneve të nevojshme të Kuvendit.

marrëveshjeve, votimit të deputetëve si dhe për t'iu ofruar qytetarëve mundësinë për t'ju drejtuar pyetje deputetëve rreth procesit të dialogut.

- Monitorimin e sesioneve të komisioneve, dëgjimeve publike, vizitave në terren për të ndjekur angazhimin e deputetëve dhe inputet e tyre.

3. VEPRIMET E KUVENDIT TË KOSOVËS

Nga ana e tij, Kuvendi i Kosovës synon që:

- Të bashkëpunojë me KDI-në përkatësisht grupet parlamentare, komisionet parlamentare dhe deputetet të angazhohen, për të mbikqyrur performancën e Qeverisë rreth procesit të dialogut, zbatimit të marrëveshjeve të arritura si dhe çështjet që do të diskutohen në të ardhmen duke marr pjesë/organizuar dëgjime publike me përfaqësuesit e ekzekutivit, duke ngritur pyetje gjatë sesioneve parlamentare, duke inicuar sesione të interpelancave për përfaqësuesit e ekzekutivit (kryenegociatorën dhe ministrat relevant) dhe duke u angazhuar në vizita në terren për të vlerësuar masën e zbatimit të marrëveshjeve të dala nga dialogu Kosovë-Serbi.
- Të bashkëpunojë me KDI-në që grupet parlamentare dhe deputetët të shfrytëzojnë konsulentat e jashtme/hulumtimet, trajnimet për tu informuar më shumë rreth politikave alternative, asistencën teknike për draftimin e pyetjeve për të propozuar amendamente konkrete rreth marrëveshjeve dhe legjislacionit të cilat derivojnë nga këto marrëveshje duke garantuar proces më gjithëpërfshirës dhe diskutime më substanciale brenda komisionit apo/dhe sesioneve parlamentare.
- Të bashkëpunojë me KDI-në për të organizuar dëgjime publike në rajonet e Kosovës me qytetarët si dhe tryezave në nivel kombëtar në koordinim me Qeverinë për të diskutuar për temat, sfidat si dhe marrëveshjet që derivojnë nga procesi i dialogut, gjatë 20 muajve të ardhshëm.
- Të bashkëpunojnë me KDI-në për të marr konsulencë të jashtme, ekspertize teknike, trajnime nga shërbimet e parlamentit zviceran për të mësuar mbi mundësitë ekzistuese në Zvicër se si ushtrohet mbikqyrja parlamentare gjatë proceseve negociuese.
- Të bashkëpunojnë me KDI-në që deputetët e Kuvendit, nëpërmjet platformës online 'Vota ime', t'iu përgjigjen pyetjeve të qytetarëve rreth procesit të dialogut dhe të përdorin këto pyetje për të mbikqyrur procesin e dialogut.
- Të bashkëpunojë me KDI-në për të organizuar diskutime ndërmjet komisioneve dhe grupeve parlamentare rreth mënyrave më efektive për të monitoruar procesin e dialogut, përfshirë mundësinë e krijimit të një komisioni të veçantë për procesin e dialogut.

BASHKËRENDIMI DHE KONSULTIMI

Pjesëmarrësit duhet t'i sigurojnë njëri-tjetrit informata të tilla që mund të jenë të nevojshme për të lehtësuar ofrimin e përkrahjes në kuadër të programit dhe për të vlerësuar ekeftivitetin e kësaj përkrahjeje. Pjesëmarrësit gjithashtu duhet të takohen periodikisht për ta rishikuar përkrahjen e ofruar në kuadër të projektit dhe për të këmbyer të dhëna relevante. çfarëdo çështje që ka të bëjnë


me interpretimin, administrimin ose zbatimin e këtij MM do të zgjidhen ndërmjet Palëve përmes konsultimeve.

4. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- I. **Efekti i MM.** Ky MM nuk përbën një detyrim ligjor ose marrëveshje detyruese.
- II. **Ndryshimet dhe Shkëputja.** Ky MM mund të ndryshohet apo modifikohet me shkrim nga Palët. Secila Palë mund të shkëpusë pjesëmarrjen e vet në këtë MM duk ei dhënë Palës tjetër njoftim me shkrim tridhjet (30) ditë paraprakisht.
- III. **Data e hyrjes në fuqi dhe afati.** Ky MM hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga të dy Palët dhe do të mbetet në fuqi për 20 muaj ose deri në shkëputje, cilado që ndodhë më herët, përpos nëse zgjatet me shkrim.
- IV. **Publiciteti.** Palët do të bëjnë publike rezultatet, veprimarit, hulumtimet, e ndërmarra si pjesë e bashkëpunimit në kuadër dhe në pajtim të kësaj MM të cilat do të publikohen edhe në ueb faqen e KDI-së.
- V. **Gjuha.** Ky MM është përgatitur në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Në rast paqartësie ose konflikti midis versioneve do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

PËR:

KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS




Kadri Veseli

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

PËR:

INSTITUTIN DEKOMRATIK TË KOSOVËS



Ismet Kryeziu

Drejtor Ekzekutiv